



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Fondi BESA SH.A – VisionFund Albania SH.P.K

Në datën 4 Nëntor 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës së Shit-Blerjes” e nënshkruar midis Fondi Besa Sh.a. (Blerësi) dhe VisionFund International (Shitësi), më datë 1 Nëntor 2016, me objekt përfitim të kontrollit, nga Fondi Besa Sh.a. të 100% të aksioneve të VisionFund Albania, e zotëruar 100 % nga VisionFund International. Njoftimi është bërë për shkak të xhiros vjetore të realizuara nga Fondi Besa sh.a.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Fondi Besa sh.a** : është një shoqëri e themeluar në Shqipëri dhe ka për objekt të aktivitetit të gjithë format e kredidhënies duke përfshirë kredinë konsumatore dhe hipotekare, ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve, shërbime këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e mësipërme;
- **VisionFund International** : një organizatë e organizuar në përputhje me Ligjin për Organizatat JoFitimprurëse Fetare të shtetit të Kalifornisë, i cili është një filial mikrofinanciar i World Vision International, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve mikrofinanciare brenda World Vision.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2, 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al